

Përfaqësuesit e shoqatës humanitare "Kalliri i mirësisë", në kuadër të së cilës funksionon edhe pushimorja për jetimet në Prevallë, "Kulla e jetimit", kanë paralajmëruar padi ndaj drejtorit të Urbanizimit të Prizrenit, Nijazi Kryeziu, për shpërdorim të detyrës zyrtare për shkak të nxjerrjes së aktvendimit për rrënimin e këtij objekti.

Në këtë shoqatë konsiderojnë se zyrtari komunal i Prizrenit ka shpërfillur autoritetin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Nga MMPH-ja kam pranuar një vendim tjetër, ndërsa tash prej Komunës një tjetër. Kjo ministri më pati urdhëruar që ato pak tejkallime që kam pasur me i largua, gjë që e kam bërë. Pas kësaj ka ardhur vendimi i DUPH-së së Prizrenit, i cili jo vetëm se është i çuditshëm, por e ka shkelur edhe autoritetin e vetë Ministrisë”, ka thënë Kemajl Januzaj nga SHH "Kalliri i mirësisë".

Ndaj vendimit të DUPH-së ai është ankuar edhe në MMPH-në dhe thotë se nuk ka marrë përgjigje zyrtare brenda afatit të paraparë, prandaj, sipas tij, janë përmbushur kushtet ligjore që të ushtrojë kallëzim penal pranë organeve të drejtësisë. /Koha Ditore/